



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2020

Datë: 27.02.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 pas diskutimit lidhur me pikën e 3 të rendit të ditës: Caktimi i Lokacionit për ngritjen e Lapidarit të Martirëve dhe të Pagjeturve të luftës së fundit në Kosovë në Parcelën me nr. P-70705044-01200-0 Z.K. Kralan. P.SH. Rrugë Publike, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lokacioni për ngritjen e Lapidarit për Martirët dhe Personat e Pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë.
2. Lokacioni ku do të ngritet Lapidari caktohet në pjesën e ngastrës kadastrale P-70705044-01200-0. Z.K Kralan, P.SH Rrugë Publike në pronësi të Komunës së Gjakovës .
3. Lapidari për Martirët dhe Personat e Pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë do të ndërtohet nga Komuna e Klinës sipas dokumentacioneve përkatëse dhe parametrave që i ofron Lokacioni i caktuar .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala